

Albania Motor Company Sh.p.k

PASQYRAT FINANCIARE
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(me raportin e audituesve të pavarur)

Permbajtja:

Raporti i Audituesit te Pavarur

Pasqyrat Financiare	Faqe
Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2024	1
Pasqyra e te ardhurave gjithëpërshirëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024	3
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024	4
Shenime Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-25

Raporti i Audituesit te Pavarur

Drejtuar Aksionereve dhe Drejtimit te Albania Motor Company sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te Shoqerise Albania Motor Company sh.p.k. ("Shoqeria"), te cilat perfshijne pasqyren e pozicionit financiar me daten 31 dhjetor 2024, pasqyren e te ardhurave gjithepershireshe, pasqyren e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyren e flukseve te parase per vitin qe mbyllet ne kete date, si edhe shenimet per pasqyrat financiare, perfshire nje permbledhje te politikave kontabel me te rendesishme.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare bashkelidhur paraqesin drejt, ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te Shoqerise me daten 31 dhjetor 2024, dhe performancen financiare dhe flukset e parase per vitin qe mbyllet ne kete date, ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

Baza per Opinionin

Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit (SNA). Pergjegjesite tona sipas ketyre standardeve jane pershkruar menyre me te detajuar ne seksionin e raportit ku jepen Pergjegjesite e Audituesit per Pasqyrat Financiare. Ne jemi te pavarur nga Shoqeria ne perputhje me Kodin e Etikes per Profesionistet Kontabel (kodi IESBA) te publikuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Etikes per Kontabilistet dhe kerkesat etike qe jane te zbatueshme per auditimin e pasqyrave financiare ne Shqiperi, si dhe, kemi permbushur pergjegjesite tona te tjera etike ne perputhje me keto kerkesa. Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene nje baze per opinionin tone.

Informacione te tjera

Informacionet e tjera perfshijne informacionin qe jepet ne raportin vjetor te Shoqerise, por nuk perfshijne pasqyrat financiare dhe raportin tone te audituesve mbi keto pasqyra. Drejtimi eshte pergjegjes per informacionet e tjera. Raporti vjetor i Shoqerise parashikohet te na vihet ne dispozicion pas dates se ketij raporti te audituesve. Opinioni yne mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonje lloj konkluzioni qe jep siguri ne lidhje me keto informacione. Ne lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi pergjegjesine te lexojme informacionet e tjera, te identifikuara me lart kur ato te na vihen ne dispozicion dhe te vleresojme nese keto informacione kane inkohenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen qe ne kemi marre gjate auditimit ose, nese duket se ato permbajne anomali materiale. Pasi te lexojme raportin vjetor, nese arrijme ne perfundimin se keto informacione permbajne anomali materiale, atehere ne duhet te komunikojme per kete ceshtje me palet e ngarkuar me qeverisjen.

Pergjegjesite e Drejtimit dhe te Personave te Ngarkuar me Qeverisjen ne lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi eshte pergjegjes per perгатitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF-te, dhe per ato kontrole te brendshme qe drejtimi i gjykon te nevojshme per te bere te mundur perгатitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali materiale, qofte per shkak te mashtrimit apo gabimit. Ne perгатitjen e pasqyrave financiare, drejtimi eshte pergjegjes per te vleresuar aftesine e Shoqerise per te vazhduar ne vijimesi, duke dhene informacion, nese eshte e zbatueshme, per ceshtjet qe kane te bejne me vijimesine dhe duke perdorur parimin kontabel te vijimesise perveç se ne rastin kur drejtimi synon ta likujdoje Shoqerine ose te nderprese aktivitetet, ose nese nuk ka alternative tjeter reale perveç sa me siper. Ata qe jane te ngarkuar me qeverisjen jane pergjegjes per mbikeqyrjen e procesit te raportimit financiar te Shoqerise.

Pergjegjesia e Audituesit per auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona jane qe te arrijme nje siguri te arsyeshme lidhur me faktin nese pasqyrat financiare ne teresi nuk kane anomalite materiale, per shkak te mashtrimit apo gabimit, dhe te leshojme nje raport auditimi qe perfshin opinionin tone. Siguria e arsyeshme eshte nje siguri e nivelit te larte, por nuk eshte nje garanci qe nje auditim i kryer sipas SNA-ve do te identifikojte gjithmone nje anomalite materiale kur ajo ekziston. Anomalite mund te vijne si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nese, individualisht ose te marra se bashku, pritet qe ne menyre te arsyeshme te influencojne vendimet ekonomike te perdoruesve, te marra bazuar ne keto pasqyra financiare.

Si pjese e auditimit ne perputhje me SNA-te, ne ushtrojme gjykimin profesional dhe skepticizmin tone profesional gjate gjithë periudhes se auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojme dhe vleresojme rrezikun e anomalive materiale ne pasqyrat financiare, si pasoje e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojme dhe zbatojme procedurat perkatese per zbulimin e ketyre rreziqeve, si edhe marrim evidence te mjaftueshme dhe te pershtatshme per te krijuar nje baze per opinionin tone. Rreziku i mos zbulimit te nje anomalie si pasoje e mashtrimit eshte me i larte, se rreziku i moszbulimit te nje anomalie si pasoje e gabimit, per shkak se, mashtrimi mund te perfshije fshehje te informacionit, falsifikim te informacionit, pervetesime te qellimshme, keqinterpretime, apo shkelje te kontrollit te brendshem.
- Marrim nje kuptuesmeri te atyre kontroleve te brendshme relevante per procesin e auditimit me qellim hartimin e procedurave te auditimit ne perputhje me rrethanat, por jo per te shprehur nje opinion mbi efektivitetin e kontroleve te brendshme.
- Vleresojme pershtatshmerine e politikave kontabel te perdorura dhe arsyetuesmerine, e cmuarjeve kontabel te kryera si edhe zbulimeve perkatese te bera nga Drejtimi.
- Shprehemi ne lidhje me pershtatshmerine e parimit te vijimesise, te zbatuar nga Drejtimi dhe, bazuar ne evidencat e marra gjate auditimit, nese ekziston nje pasiguri materiale ne lidhje me ngjarjet ose kushtet qe mund te hedhin dyshime domethenese mbi aftesine e Shoqerise per te vazhduar sipas parimit te vijimesise. Nese arrijme ne perfundimin se nje pasiguri materiale ekziston, ne jemi te detyruar te terheqim vemendjen ne raportin e auditimit tek informacioni i paraqitur ne shenimet shpjeguese te lidhura me pasqyrat financiare ose, nese informacioni i paraqitur ne shenimet shpjeguese eshte i pamjaftueshem, duhet te modifikojme opinionin tone. Konkluzionet tona te auditimit bazohen ne evidencat e auditimit te marra deri ne daten e raportit te auditimit. Megjithate, ngjarjet ose kushtet ne te ardhmen mund t'i shkaktojne Shoqerise nderprerjen e vazhdimet te perputhje me parimin e vijimesise.
- Vleresojme prezantimin e pergjithshem, strukturen dhe permbajtjen e pasqyrave financiare vjetore, duke perfshire dhenien e informacioneve shpjeguese, si dhe nese pasqyrat financiare vjetore paraqesin transaksionet dhe ngjarjet kryesore ne menyre qe te arrihet nje paraqitje e drejte.

Ne komunikojme me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqerise, pervec ceshtjeve te tjera, edhe objektin dhe kohen e planifikuar te auditimit, gjetjet kryesore te auditimit, perfshire çdo mangesi relevante ne kontrollin e brendshem te identifikurgjate auditimit tone.

BDO ALBANIA SHPK

BDO Albania sh.p.k.

20 mars 2025

Tirane, Shqiperi




BDO ALBANIA sh.p.k.

NIPT L02407004C

TIRANA - ALBANIA

Besjana Doda
Partner Angazhimi




Albania Motor Company Sh.p.k
Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2024
 (Te gjitha shumat ne Lek)


	Shenime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktive			
Aktive afatgjata materiale	6	53,206,500	57,387,277
Aktive afatgjata jo materiale		260,425	306,383
Totali i aktiveve afatgjata		53,466,925	57,693,660
Inventari	7	916,554,600	863,081,834
Llogari te arketueshme	8	328,653,611	370,398,300
Te drejta ndaj paleve te lidhura	9	201,135,653	236,823,727
Aktive te tjera	10	83,688,210	60,330,480
Paraja dhe ekuivalentet e saj	11	38,868,514	38,536,494
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,568,900,588	1,569,170,836
Totali i aktiveve		1,622,367,513	1,626,864,496
Kapitali dhe detyrimet			
Kapitali aksioner	12	215,644,000	215,644,000
Rezerva ligjore		5,829,246	5,829,246
Fitimi i pashperndare		134,561,095	185,043,062
Totali i kapitalit		356,034,341	406,516,308
Huamarrje - pjesa afatshkurter	13	-	-
Detyrime ndaj paleve te lidhura	14	784,629,362	804,890,789
Llogari te pagueshme	15	37,276,900	54,058,549
Tatim fitimi i pagueshem	16	-	-
Detyrime te tjera	16	444,426,909	361,398,850
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,266,333,171	1,220,348,188
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		1,622,367,513	1,626,864,496

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet qe jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare, ne faqet nga 5 deri 25.

Keto pasqyra financiare u aprovuan nga drejtimi i Albania Motor Company Sh.p.k ne 06 mars 2025 dhe u nenshkruan ne emer te tij nga:


 Gentjan Karaj
 Drejtor i pergjithshem




 Aretuza Kuleci
 Drejtoreshe e Finances

	Shenime	2024	2023
Te ardhurat	17	3,020,462,251	4,010,066,203
Kosto e shitjeve	18	(2,613,641,453)	(3,521,691,378)
Fitimi bruto		406,820,798	488,374,824
Te ardhura te tjera operative	19	9,813,256	11,123,368
Shpenzime personeli	20	(94,090,378)	(84,437,502)
Amortizimi	6	(9,045,180)	(8,783,478)
Shpenzime administrative	21	(162,908,432)	(202,561,526)
		(256,230,734)	(284,659,137)
Fitimi operativ		150,590,064	203,715,687
Te ardhura financiare			
Shpenzime financiare		8,906,276	15,719,810
Te ardhura/shpenzime financiare neto	22	8,906,276	15,719,810
Fitimi para tatimit		159,496,340	219,435,498
Tatimi mbi fitimin	23	(24,935,244)	(34,392,436)
Fitimi neto per vitin		134,561,095	185,043,062
Te ardhura te tjera permbledhese			-
Totali i te ardhurave permbledhese per vitin		134,561,095	185,043,062

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e te ardhurave te tjera gjitheperfshirese duhet lexuar se bashku me shenimet qe jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare ne faqet nga 5 deri 25.

Albania Motor Company Sh.p.k
Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024
(Te gjitha shumat ne Lek)

	Kapitali aksioner	Rezerva ligjore	Fitimi i pashperndare	Totali
Gjendja me 1 janar 2023	215,644,000	5,829,246	171,629,054	393,102,300
Totali i te ardhurave permbledhese per vitin				
Fitimi neto per vitin	-	-	185,043,062	185,043,062
Te ardhura te tjera permbledhese, neto nga tatim fitimi	-	-	-	-
Totali i te ardhurave permbledhese per vitin	215,644,000	5,829,246	356,672,116	578,145,362
Transaksione me pronaret, regjistruar direkt ne capital				
Shperndarje dividendesh			(171,629,054)	(171,629,054)
Totali i kontributeve nga pronaret dhe shperndarje pronareve	215,644,000	5,829,246	185,043,062	406,516,308
Gjendja me 1 janar 2024	215,644,000	5,829,246	185,043,062	406,516,308
Totali i te ardhurave permbledhese per vitin				
Fitimi neto per vitin	-	-	134,561,095	134,561,095
Te ardhura te tjera permbledhese, neto nga tatim fitimi	-	-	-	-
Totali i te ardhurave permbledhese per vitin	215,644,000	5,829,246	319,604,157	541,077,403
Transaksione me pronaret, regjistruar direkt ne capital				
Shperndarje dividendesh	-	-	(185,043,062)	(185,043,062)
Totali i transaksioneve me pronaret	215,644,000	5,829,246	134,561,095	356,034,341
Gjendja me 31 dhjetor 2024	215,644,000	5,829,246	134,561,095	356,034,341

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet qe jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare ne faqet nga 5 deri 25.

Albania Motor Company Sh.p.k
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024
(Te gjitha shumat ne Lek)

		2024	2023
	Shenime		
I	Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytezimit		
	Fitimi para tatimit	23	159,496,340
	Rregullime per shpenzimet jo monetare		219,435,498
	Zhvleresimi i aktiveve afatgjata material	6	9,045,180
	Humbje nga kembimet valutore		8,783,478
	Shpenzime per interesa		
	Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera		54,075,034
			82,283,745
	Rritje/renie ne Tepricen e inventarit	(53,472,766)	(359,769,228)
	Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve per tu paguar nga aktiviteti	45,984,983	196,881,425
	<i>MM te perfituara nga aktivitetet</i>	<u>215,128,770</u>	<u>147,614,917</u>
	Interesi i paguar		
	Tatim mbi fitimin i paguar	(24,935,244)	(34,392,436)
	<i>MM neto dhe ekuivalente nga aktivitetet e shfrytezimit</i>	<u>190,193,526</u>	<u>113,222,481</u>
II	Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	6	(6,329,780)
			(15,833,939)
	Te ardhura nga shitja e paisjeve	6	1,511,335
			2,788
	Interesi i arketuar		
	<i>MM neto dhe ekuivalente te perdorura ne veprimtarite investuese</i>	<u>(4,818,444)</u>	<u>(15,831,150)</u>
III	Fluksi monetar nga aktivitetet financiare		
	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		
	Te ardhura nga huamarrje afatgjata		
	Pagesat e detyrimeve te qerase financiare		
	Dividente te paguar	(185,043,062)	(171,629,054)
	<i>MM neto dhe ne veprimtarite Financiare ekuivalente e perdorur</i>	<u>(185,043,062)</u>	<u>(171,629,054)</u>
IV	Rritja/Renia neto e mjeteve monetare	<u>332,020</u>	<u>(74,237,723)</u>
V	Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	<u>38,536,494</u>	<u>112,774,217</u>
VI	Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	<u>38,868,514</u>	<u>38,536,494</u>

Pasqyra e flukseve te mjeteve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet qe jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare ne faqet nga 5 deri 25

Informacion i pergjithshem

Albania Motor Company Sh.p.k ("Shoqeria") e filloi aktivitetin e saj ne 2004 si nje shperndares ekskluziv per Ford Motor Company ne Shqiperi. Gjate vitit 2021 ajo zgjeroi shitjet e markes edhe per Hyundai. Shoqeria eshte regjistruar si nje person juridik sipas vendimit te Gjykates date 27 maj 2004, me numer NIPT-i K41829010I dhe certificate fiskale numer 3000912. Zyra qendrore eshte vendosur ne Kashar, Tirane, Shqiperi.

Dy aksioneret e Shoqerise jane Iner Sh.p.k., i cili zoteron 50% te aksioneve dhe Grand Dalewest Limited, nje shoqeri e regjistruar ne Qipro, e cila zoteron 50% te aksioneve te Shoqerise.

Aktiviteti kryesor i Shoqerise eshte importi, shitja dhe qiradhenia e autoveturave dhe importi dhe shitja e pjeseve te kembimit. Gjithashtu, Shoqeria ofron sherbimin e servisit dhe mirembajtjes se makinave. Qe nga viti 2006 Shoqeria ka nje seli qe gjendet ne kilometrin e 10-te te autostrades Tirane - Durres. Gjithashtu Shoqeria ofron edhe motorra uji, motoskafe dhe motorra per ski (duke marre statusin e distributorit per Bombardier Recreational Products ne 2007).

Ne 31 dhjetor 2024, Shoqeria kishte 49 punonjes (2023: 47 punonjes).

Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

Politikat kryesore te kontabilitetit te adaptuara ne pergatitjen e pasqyrave financiare, jane ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("SNRF"). Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne parimin e koston historike. Monedha e raportimit eshte Leku Shqiptar ("Lek") qe eshte gjithashtu edhe monedha funksionale.

Pasqyrat financiare te Shoqerise pergatiten mbi baze te parimit te vijimesise, i cili merr parasysh se Shoqeria do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj per nje te ardhme te parashikuar.

2.2 Zbatimi i standardeve nderkombetare te reja dhe te rishikuara te raportimit financiar

2.1.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale

Politikat kontabel te miratuara jane ne perputhje me ato te vitit financiar te meparshem, me perjashtim te politikave te meposhtme te cilat jane adoptuar nga Shoqeria me 1 janar 2024:

- SNRF 16 - Qiratë në shitje dhe kthim nga qirate (Amendamenti i SNRF 16);

Këto ndryshime përfshijnë kërkesat për transaksionet e shitjes dhe të kthimit nga qirate në SNRF 16 për të shpjeguar se si një njësi ekonomike llogarit një shitje dhe kthim nga qira pas datës së transaksionit. Transaksionet e shitjes dhe kthimit me qira ku disa ose të gjitha pagesat e qirasë janë pagesa të ndryshueshme të qirasë që nuk varen nga një indeks ose normë kanë më shumë gjasa të ndikohen.

- SNK 1 - Paraqitja e Pasqyrave Financiare Marrëveshjet (Ndryshimet në SNK 1);

Amendamenti sqaron se si kushtet me të cilat një njësi ekonomike duhet të përmbushë brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës raportuese ndikojnë në klasifikimin e një pasivi.

- SNK 7 dhe SNRF 7 - Financat nga furnizuesit (Ndryshimi i SNK 7 dhe SNRF 7);

Këto ndryshime kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese për të rritur transparencën e marrëveshjeve financiare të furnizuesit dhe efektet e tyre në detyrimet, flukset monetare dhe ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit të një njësie ekonomike. Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese janë përgjigja e BSNK-së ndaj shqetësimeve të investitorëve të marreveshjeve financiare të disa kompanive me furnizues nuk janë mjaftueshëm të dukshme, duke penguar analizën e investitorëve.

Keto ndryshime nuk kane ndikim ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

2.1.2 Standarde dhe interpretime te reja qe nuk kane hyre ende ne fuqi dhe ende nuk jane zbatuar perpara dates efektive

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por qe nuk kane hyre ende ne fuqi, deri ne daten e deklarimit te pasqyrave financiare te Shoqerise, jane pasqyruar me poshte. Shoqeria synon te adoptoje keto standarde, nese jane te aplikueshme, kur ato te behen efektive.

Ndryshimet e meposhtme jane ne fuqi per periudhen qe fillon me 1 janar 2025:

- SNK 21 - Mungesa e këmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21);
Një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2025; Ndryshimet paraqesin kërkesa për të vlerësuar kur një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër dhe kur jo. Ndryshimet kërkojnë që një njësi ekonomike të vlerësojë kursin e këmbimit momental kur arrin në përfundimin se një monedhë nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër.

Shoqeria parashikon qe adoptimi i ketij standard te cilat nuk jane ende ne fuqi, nuk do te kene ndikim material ne pasqyrat financiare te Shoqerise ne periudhen e aplikimit fillestar.

3. Gjykime dhe Vleresime te Rendesishme Kontabile

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon qe drejtimi te kryeje gjykime, çmuarje dhe supozime te cilat ndikojne ne aplikimin e politikave dhe shumave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne veçanti, informacion mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare. Perdorimi i vleresimeve kontabel eshte minimal ne keto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtesine e veprimeve te realizuara nga Shoqeria.

Pasiguria ne gjykime

Zhvleresimi i aktiveve jofinanciare

Humbjet nga zhvleresimi do te njihen ne vleren ne te cilen vlere kontabel e aktiveve ose e njesise gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme. Kur percaktohet vlere e rikuperueshme, drejtimi vlereson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga cdo njesi gjeneruese e parase dhe percakton nje norme interesi te pershtatshme kur llogaritet vlere aktuale e ketyre flukseve te parase.

3. Gjykime dhe Vleresime te Rendesishme Kontabile (vazhdim)

Jeta e dobishme e aktiveve te amortizueshme

Drejtimi rishikon rregullisht jetet e dobishme te aktiveve te amortizueshme ne daten e pasqyres se pozicionit financiar. Drejtimi vlereson nese jeta e percaktuar si e dobishme e aktiveve, perfaqeson dobishmerine e pritur te aktiveve. Vlerat kontabel e ketyre aktiveve analizohet ne Shenimin 6. Megjithate, rezultatet faktike mund te ndryshojne per shkak te vjeterimit teknologjik dhe faktoreve te tjere.

Zhvleresimi i aktiveve financiare

Zhvleresimi i llogarive te arketueshme dhe te tjera te arketueshme

Shoqeria llogarit zhvleresimin per llogarite e arketueshme dhe per llogarite e tjera te arketueshme bazuar ne humbjet e vleresuara qe rezultojne nga paaftesia e klienteve per te bere pagesat e kerkuara. Vleresimi eshte bazuar ne vjeterimin (aging) e gjendjes se llogarive te arketueshme dhe pervojen historike te shlyerjes, kreditin e konsumatoreve dhe ndryshimeve ne aspektin e pagesave te konsumatoreve gjate vleresimitte humbjes nga zhvleresimi per llogarite e dyshimta. Keto perfshijne supozime mbi sjelljen e konsumatoreve dhe mbledhjen e mjeteve monetare te ardhshme qe rezulton prej saj. Nese gjendja financiare e klienteve do te perkeqesohej, zhvleresimi aktual i llogarive te arketueshme ekzistuese mund te jete me i larte se sa pritet dhe mund te tejkaloje nivelin e humbjeve nga zhvleresimi te njohura deri tani.

Inventaret

Inventari fillimisht rregjistrohen me kosto, qe perbehet nga cmimi i blerjes duke shtuar dhe kostot e drejtperdrejta si transport dhe parking, akcize, kosto e analizes se cilesise te mallit te importit dhe taksat e agjensise doganore. Inventari me pas paraqitet me vleren me te ulet mes kosos dhe vleres neto te realizueshme. Kur percakton vleren neto te realizueshme, drejtimi merr parasysh provat me objektive / te dhenat ne dispozicion te marra gjate kryerjes se vleresimeve. Vlera neto e realizueshme eshte e vleresuar me cmimin e shitjes gjate aktivitetit normal minus shpenzimet e nevojshme per te bere produktin gati per t'u shitur.

4 Permbledhje e Politikave te Rendesishme Kontabile

4.1. Aktivet afatgjata materiale dhe jo-materiale

Aktivitet afatgjata material dhe jo materiale jane deklaruar me vleren kontabel neto, pas zbritjes se amortizimit te akumuluar dhe/ose humbjeve te akumuluar nga zhvleresimi, nese ka.

Kjo kosto historike perfshin shpenzimet qe lidhen direkt me blerjen e aktiveve. Kosto e aktiveve te ndertuara vete perfshin koston e lendeve te para dhe punes, dhe cdo kosto tjeter qe lidhet direkt me sjelljen e aktivitet ne gjendje pune, kostot e cmontimit dhe heqjes se mjeteve dhe rikonstrukcioni i vendit ku ato jane vendosur dhe kostot e kapitalizuara te huamarrjes. Kostot shtese jane perfshire ne vleren e aktivitet ose njihet si nje aktiv i vecante, sipas nevojës, vetem kur eshte e mundur qe perfitimet ekonomike te ardhshme te lidhura me artikullin do te hyjne ne Shoqeri dhe kostoja e artikullit mund te matet me besueshmeri. Te gjitha riparimet dhe mirembajtjet e tjera, ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfishirese gjate periudhes financiare ne te cilen ato kryhen.

4 Permbledhje e Politikave te Rendesishme Kontabile (vazhdim)**4.1. Aktivet afatgjata materiale dhe jo-materiale (vazhdim)**

Normat vjetore te amortizimit te aplikuara jane si me poshte:

Kategoria	Metoda Amortizimit	Jetegjatesia/ Norma amortizimit
Ndertesa	Metoda lineare	20 vjet
Makineri dhe paisje	Vlera e mbetur	20%
Automjete	Vlera e mbetur	20%
Automjete me leasing financiar	Metoda lineare	5 vjet
Mobilje dhe paisje informatike	Vlera e mbetur	20-25%

Vlerat e mbetura dhe jeta e perdorimit te aktiveve jane rishikuar, dhe rregulluar nese eshte e pershtatshme, ne daten perkatese te pozicionit financiar. Vlera kontabel e nje aktivi eshte zhvleresuar menjehere ne vleren e tij te rikuperueshme nese vlera kontabel e aktivitet eshte me e madhe sesa shuma qe vleresohet te rikuperohet. Fitimet dhe humbjet nga shitjet e aktiveve, jane percaktuar duke krahasuar te ardhurat me vleren e aktivitet. Keto jane te perfshira ne pasqyren e te ardhurave gjithheperfshirese.

4.2. Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj jane te konvertuara ne leke dhe regjistrohen duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivet monetare dhe zera te tjere jo monetare ne monedhe te huaj rivleresohen ne leke me kursin e kembimit te Bankes se Shqiperise ne daten e fundit te periudhes raportuese. Diferencat e kembimit valutor jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave gjithheperfshirese te Shoqerise. Kursi zyrtar i kembimit per monedhat kryesore per perkthimin e zerave te pozicionit financiar te shprehur ne monedhe te huaj paraqiten si vijon (ne Leke):

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
1 EUR	98.15	103.88
1 USD	94.26	93.94

4.3. Instrumentet financiare

Shoqeria fillimisht njeh llogarite e arketueshme dhe depozitat monetare ne daten kur ato jane krijuar. Aktivet Financiare klasifikohen ne njohjen fillestar dhe maten me vone me kosto te amortizueshme, me vlere te drejte nepermjet te ardhurat gjithheperfshirese (OCI), dhe me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes. Te gjitha aktivet e tjera financiare (duke perfshire aktivet e percaktuara me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht ne daten e tregtimit ne te cilen Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Shoqeria c'regjistron nje aktiv financiar kur te drejtat kontraktuale te flukseve te mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojne, ose kur transferon te drejtat per te marre flukse nga aktivi financiar ne nje transaksion ne te cilin kryesisht te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesise se aktivitet financiar jane transferuar. Cdo interes ne aktivet financiare te transferuara qe perfitohet ose mbahet nga Shoqeria eshte njohur si nje aktiv apo detyrim i vecante. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet ne pasqyren e pozicionit financiar kur, dhe vetem kur, Shoqeria ka te drejte ligjore per te netuar shumat dhe synon ose te shlyeje mbi nje baze neto ose te realizoje aktivin dhe te shlyeje detyrimin ne te njejten kohe. Instrumentet financiare jo-derivative te Shoqerise perfshijne llogarite e kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme, mjetet monetare, dhe furnitoret dhe detyrime te tjera.

4 Permbledhje e Politikave te Rendesishme Kontabile (vazhdim)

4.3. Instrumentet financiare

Mjetet monetare

Mjetet monetare perfshijne parate e mbajtura ne bankat lokale ne monedhen vendase dhe te huaj dhe paraqiten me kosto.

Llogari e kerkesa te arketueshme dhe Llogari e kerkesa te tjera te arketueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, duke zbritur provigjonet per zhvleresim. Nje provigjon per zhvleresimin i llogarive te arketueshme krijohet kur ka evidence objektive se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha shumat sipas kushteve fillestare te llogarive te arketueshmeve.

Veshtiresi te rendesishme financiare te debitorit, probabiliteti qe debitori do te hyje ne falimentim ose riorganizim financiar, dhe mospagesa ose veshtiresi ne pagesa konsiderohen si tregues se llogaria e arketueshme eshte zhvleresuar. Shuma e provigjonit eshte diferenca midis vleres kontabel te aktivitetit dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te vleresuara, te skontuara me normen fillestare te interesit efektiv. Aktiviteti me maturim te shkurter nuk jane skontuar. Vlera kontabel e aktivitetit zvogelohet nepermjet perdorimit te nje llogarie zbritje, dhe shuma e humbjes njihet ne pasqyren e te ardhurave gjitheperفشيره. Kur nje llogari e arketueshme eshte e pambledhshme, ajo eshte zbritur kundrejt llogarise se zhvleresimit per llogarise e arketueshme. Rikuperimet pasuese te shumave te zbritura me pare jane kredituar ne pasqyren e te ardhurave gjitheperفشيره.

Furnitoret dhe detyrime te tjera

Furnitoret dhe detyrime te tjera jane pasqyruar fillimisht me vlere te drejte dhe me pas me koston e amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Huate dhe kredite

Huate dhe kredite maten fillimisht me vleren e drejte, neto per koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten me pas me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, nderkohe qe shpenzimet e interesit njihen me normen efektive te interesit. Metoda e interesit efektiv eshte nje metode e llogaritjes se koston e amortizuar te nje detyrimi financiar dhe e regjistrimit te shpenzimeve te interesit gjate periudhes perkatese. Norma e interesit efektiv eshte norma qe skonton pagesat e ardhshme monetare te vleresuara gjate jetes se pritshme te detyrimit financiar, ose, kur eshte e pershtatshme, gjate nje periudhe me te shkurter.

4 Permbledhje e Politikave te Rendesishme Kontabile (vazhdim)

4.4. Zhvleresimet

Aktivitet financiar

Nje aktiv financiar qe nuk mbahet me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes, vleresohet ne cdo date raportimi per te percaktuar nese ka nje evidence objektive se ai eshte zhvleresuar. Shoqeria njejte zhvleresim per humbjet e pritshme te kredise (ECL) per te gjitha instrumentet e borxhit qe nuk mbahen me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes. ECL bazohen ne diferencen ndermjet flukseve monetare kontraktuale qe duhet te paguhet ne perputhje me kontraten dhe te gjitha flukse monetare qe Shoqeria pret te marre, te skontuara me nje parafrim te normes fillestare te interesit efektiv. Flukset monetare pritet te perfshijne flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit te mbajtur ose te ardhura te tjera qe jane pjese perberese e kushteve kontraktuale. Humbja nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me koston e amortizuar eshte llogaritur si diferenca midis vleres kontabel dhe vleres aktuale te flukseve monetare te vleresuara te ardhshme te skontuara me normen fillestare te interesit efektiv te aktivitetit. Humbjet njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese (fitim ose humbje) dhe pasqyrohen ne nje llogari zhvleresimi perkundrejt llogarive te arketueshme. Interesat mbi aktivitetin e zhvleresuara vazhdojne te njihen nepermjet skontimeve te pandryshueshme. Kur nje ngjarje pasuese ndikon ne uljen e shumes se zhvleresimit, renia ne humbjen nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese. Per te llogarite e arketueshmet tregtare, Shoqeria zbaton nje qasje te thjeshtuar ne llogaritjen e ECLs. Si rrjedhoje, Shoqeria nuk ndjek ndryshimet ne rrezikun e kredise, por ne vend te kesaj njejte humbje nga zhvleresimi te bazuar ne jetgjatesine e ECL-ve ne cdo date raportimi. Shoqeria ka krijuar nje matrice provizionesh qe bazohet ne pervojen e saj historike te humbjeve nga kreditimi, te pershtatur per faktoret e ardhshem qe jane specifike per debitoret dhe mjedisin ekonomik.

Aktivitet jo-financiar

Vlerat kontabel e aktiveve jo-financiare te Shoqerise rishikohet ne daten e raportimit per te percaktuar nese ka evidence per zhvleresim. Nese ka evidence te tilla, atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme eshte me e madhja midis vleres se drejte minus koston per shitje dhe vleres ne perdorim. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset e ardhshme te mjeteve monetare jane skontuar ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave qe reflekton vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziqet specifike per aktivitetin per te cilat vleresimet e flukseve monetare te ardhshme nuk jane rregulluar. Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabel e nje aktivi ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare tejkalon vleren e rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese (ne fitim ose humbje).

4.5 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat perfshijne te ardhurat nga shitja e mallrave dhe kryerja e sherbimeve.

Te ardhurat maten duke ju referuar vleres se drejte te shumes se marre ose te arketueshme nga Shoqeria per mallrat e shitura dhe te sherbimeve te ofruara, duke perjashtuar taksat e shitjeve, rimbursimet, dhe skontot tregtare.

